



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Integrimin European

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9643, DATË
20.11.2006 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 13.12.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Axsensia e Prokurimit Publik e përfaqësuar nga Znj. Reida Kashta, Drejtor i Përgjithshëm.

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij projektligji është mospërfitimi i fondeve publike jo vetëm nga operatorët të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të cituara në nenin 1 të këtij projektligji, por edhe në rastet kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik..

Plani Kombëtar për Integrimin European

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar” është i parashikuar në **Kapitullin 5: Prokurimi Publik**”

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njeh rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;

- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE): **Neni 114** (ish-neni 95 TKE)
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VI “*Përafrimi i legjislacionit, zbatimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës*”, **Neni 70, pika 3; Neni 74 “Kontratat publike”**.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 “Mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE”.

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit në tërësi të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

3. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Duhet shtuar shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 “Mbi prokurimin publik dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE”. Numri CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.94, datë 28.03.2014, faqe 65 - 242”.

2. Në nenin 1, pika 1 të projektligjit që parashikon ndryshimin e nenit 45, pika 1 të ligjit në fuqi për prokurimin publik, paragrafi i dytë i pikës 1 të nenit 45 të riformulohet si vijon:

“Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik, zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij **operatori ekonomik**, aksionar ose ortak, ose ka kompetenca përfaqësuese,

4. KORRIGJIMI I TABELËS SË PËRPUTHSHMËRISË QË SHOQËRON PROJEKTLIGJIN

Versioni shqip i Tabelës së Përputhshmërisë që shoqëron projektligjin duhet të korrigjohet nga institucioni propozues, sepse nuk është plotësuar sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015 dhe VKM-ja Nr.233, datë 18.03.2015):

Në versionin shqip të tabelës së përputhshmërisë që shoqëron projektligjin, titulli dhe referencat e tjera të aktit ligjor të BE-së me të cilin është përafruar projektligji janë shënuar në gjuhën angleze, ndërkohë që duhen shënuar në gjuhën shqipe.

Në tabelën e përputhshmërisë që shoqëron projektligjin, shkalla e përafrimit në tërësi të projektligjit me aktin ligjor të BE-së me të cilin është përafruar, është shënuar si “përputhshmëri e plotë”, ndërkohë që është “përputhshmëri e pjesshme”. Vetëm teksti i nenit 1, pika 1 të projektligjit që ndryshon pikën 1 të nenit 45 të ligjit në fuqi për prokurimin publik, është përafruar plotësisht me pikën 1 të nenit 57 të Direktivës 2014/24/BE, por në tërësi, shkalla e përafrimit të projektligji me këtë direktivë të BE-së është e pjesshme.

Bazuar në nenin 17, pika 3 të ligjit 15/2015 “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian*”, sugjerojmë që KIE t’i kërkojë institucionit propozues të projektligjit:

- korrigjimin e tabelës së përputhshmërisë, duke shënuar në gjuhën shqipe titullin dhe referencat e tjera të aktit ligjor të BE-së me të cilin është përafruar projektligji, si dhe duke shënuar shkallën e saktë të përputhshmërisë në tërësi të projektligjit (i.e. “përputhshmëri e pjesshme”) me aktin ligjor të BE-së me të cilin është përafruar,
- ridërgimin e tabelës së korrigjuar të përputhshmërisë në Kuvend.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit e miratoi atë shumicë votash.

**NËNKRYETAR
BLENDAR ÇUÇI**